



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2015, për transparencë në Komuna, nenit 32 pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2017, merr këtë

V E N D I M

PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE LIDHUR ME RREGULLOREN PËR TË HYRAT VETJAKE TË INSTITUCIONEVE KULTURORE VARTËSE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I.

Miratohet Vendimi për dërgimin e Rregullores për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës, në konsulta paraprake publike.

II.

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në pikën I, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatave informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

III.

Konsultat paraprake publike për rregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi, do të zgjasin 15 ditë.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Kulturës.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 640/02-0182520/17, më 26.07.2017.



KRYETAR I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.